



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:151197
Datë: 25.05.2024
Numri i dokumentit: 05734755

C.nr.1221/22.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Driton Nocaj, në çështjen juridike–kontestimore të paditëses D.B nga K.P, të cilën e përfaqëson F.M avokat nga Peja, kundër të paditurës K.P-D.K.A P, baza juridike: *Kompensim mbi bazën e inflacionit*, vlera e kontestit 1000.00 euro duke vendosur jashtë seance me datë 25.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET- e tërhequr padia paditëses D.B nga Peja, kundër të paditurës K.P-D.K.A P, baza juridike: *Kompensim mbi bazën e inflacionit*, vlera e kontestit 1000.00 euro, e parashtruar me datë 26.07.2022, me numër C.nr.1221/22.

II.Secila palë në procedurë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja D.B, të cilën e përfaqëson F.M avokat nga Peja, pranë kësaj gjykate me datë 26.07.2022, ka paraqitur padi, kundër të paditurës K.P-D.K.A P, baza juridike: *Kompensim mbi bazën e inflacionit*, vlera e kontestit 1000.00 euro.

I autorizuari i paditësit përmes parashtrësës të datës 20.05.2024, e ka njoftuar gjykatën se paditësja e ka realizuar kërkesën e saj, dhe nuk ka interes që kjo çështje të vazhdojë në rrugë gjyqësore.

Gjykata e shqyrtoj propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe konstatoj se me rastin konkret kemi të bëjmë me të drejta konform nenit 3 të LPK-së, andaj gjykata pa u lëshuar në shqyrtimin e mëtutjeshëm e aprovoj propozimin e të autorizuarit të paditësit për tërheqjen e padisë.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 261, në lidhje me nenin 261.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

G j y q t a r i:

Driton Nocaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet ankimi.